



#1 Buçan, Pejë

Komuna e Pejës

Komuna e Pejës përfshin qytetin e Pejës dhe 78 vendbanime tjera dhe 19,639 shtëpi. Mesatarisht, në çdo fshat janë 113 shtëpi dhe 533 banorë. Në të gjitha fshatrat ekziston infrastrukturë rrugore, përfshirë rrugë të asfaltuara, ndriçim publik dhe trotuare. Shumica e fshatrave janë të pajisur me ndriçim publik dhe në disa fshatra janë duke u zhvilluar punimet për instalimin e ndriçimit.




Grafikoni lartë tregon rritjen e popullatës në Komunën e Pejës deri më 1991 dhe rënie të popullatës për 35% deri më 2024. Është interesante që numri i familjeve nuk ka rënë në nivel të komunës, por ka rënë në qytet (shih grafikun më poshtë) për rreth 20%. Në qytetin e Pejës ka rënë popullsia për rreth 30%.



Grafikoni më poshtë tregon rënien e ekonomisë familjare, nga një mesatare prej 8 në 4.5 në fshatra dhe 3.9 në qytet. Mbase shkaku i rënies është pjesërisht rënia demografike dhe pjesërisht fakti që tani pakkush jeton me familje të gjërë në një shtëpi.

Seria e rasteve studimore për punësim të grave në zonat rurale

Papunësia dhe arsimi i dobët i grave në zonat rurale mbeten mes sfidave më serioze socio-ekonomike në Kosovë, e cila rrjedh jo vetëm nga mungesa e vendeve të punës, por edhe nga barrierat strukturore si mungesa e transportit publik, shërbimeve parashkollore dhe mundësive për zhvillim personal. Për të adresuar këtë realitet, projekti “Vendimarrja me dialog: Përmirësimi i jetës rurale përmes avokimit të grupeve të interesit”, i zbatuar nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) me mbështetjen e projektit rajonal “SMART Balkans–Shoqëria Civile për Vlera të Përbashkëta në Ballkanin Perëndimor”, synon të promovojë një qasje të re në politikëbërje. Dëshmitë nga disa mini-studime që kemi realizuar synojnë të nxisin dialog dhe pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të grave në procesin e vendimarrjes publike. Argumenti ynë kryesor është për një bashkëpunim të qëndrueshëm mes shoqërisë civile dhe institucioneve, me qëllim krijimin e zgjidhjeve konkrete për të lehtësuar qasjen e grave në tregun e punës përmes dy intervenimeve publike: (a) hapja e sa më shumë kopshteve për të akomoduar fëmijët nga zonat rurale dhe (b) subvencionimi i transportit publik që lidh fshatrat me qytete dhe mes vete. Të gjitha dëshmitë janë se këto dy ndërhyrje do të rrisnin barazinë mes fëmijëve, do të rrisnin punësimin e grave, do të ngadalësonin shpërnguljen dhe në përgjithësi do të kishin efekt për një zhvillim më të hovshëm ekonomik në vend. Në kuadër të këtij projekti u krijua një Grup Avokues i Grave Aktiviste, i cili me mbështetje nga D4D, ka realizuar disa hulumtime në nivel të Kosovës dhe në disa fshatra të përzgjedhura për të identifikuar faktorët kryesorë që ndikojnë në papunësinë e grave, duke vendosur kështu bazën për propozime të strukturuar dhe të adresuara politikisht.




Kopshtet për fëmijë. Në Pejë është një kopsht publik “Pëllumbat e Paqes” i cili funksionon në tri lokacione brenda qytetit me gjithsej 410 fëmijë. Kushti për pranimin e tyre është që të dy prindërit të jenë të punësuar. Duke qenë se në fshatra pjesa më e madhe e popullsisë merret me bujqësi dhe gratë rrallëherë kanë punësim formal, mund të supozohet që shumica absolute e fëmijë në kopsht janë nga qyteti. Sa u përket

institucioneve private, aktualisht në Komunën e Pejës funksionojnë gjithsej 12 kopshte të gjitha në qytet.

Në fshatrat e Pejës nuk ka kopshte fare, as publike dhe as private. Nga muaji shtator 2025 pritet të funksionalizohet kopshti i parë në fshatin Vitomiricë, i cili do të jetë institucion publik nën ombrellën e kopshtit “Pëllumbat e Paqes”.

Sa i përket numrit të fëmijëve në çerdhen publike aktualisht janë 410 fëmijë ndërsa për institucionet private nuk ka të dhëna të sakta as nga Drejtoria Arsimit dhe as nga Inspektorati i Arsimit, por në ASK figuron numri prej 540 që është përdorur në grafikonin në të djathtë.



Transporti publik në fshatrat e Komunës së Pejës mbetet i kufizuar dhe menaxhohet kryesisht nga kompani private. Linjat e autobusëve funksionojnë kryesisht gjatë orareve shkollore, ndërsa shërbimi i fundit zakonisht realizohet rreth orës 18:00. Një nga linjat e rregullta të transportit publik qarkullon katër herë në ditë dhe përshkon këtë rrugë: Nepole – Glllogjan – Kosuriq – Qallapek – Baran – Vranoc – Kotradiq – Rashiq – Kryshec – Zllapek – Raushiq – Pejë. Kjo linjë u shërben banorëve të këtyre fshatrave për të udhëtuar drejt qytetit dhe anasjelltas. Fshatrat tjera kryesisht shërbehen me linjë 2 herë në ditë që përkon me oraret e shkollave.

Kriteri që dy prindërit të jenë të punësuar, ndihmon pikërisht ata që i kanë kushtet më të mira financiare.

Tabela më poshtë (me të dhënat nga regjistrimi i fundit i popullsisë) shpërfaq lëvizjet e dekadës së fundit, duke treguar që ka fshatra që janë buzë zhdukjes, ka fshatra të rinj, ka fshatra që janë rritur. Kryesisht ka rënie të popullatës në tërë komunën (13,700 banorë), ashtu siç ka rënie edhe në tërë Kosovën. Madje edhe qyteti ka rënie për 7,800 banorë. Është interesante se rënia e popullatës në fshatra është 14% përderisa në qytet është 19%. Mbase duhet të hulumtohet nëse migrimi drejt qytetit sjell edhe dëshpërim dhe më vonë migrim jashtë vendit.

Vendi	2024	2011	Dallimi	Vendi	2024	2011	Dallimi
Komunë	82,745	96,450	-13,705.00	Jabllanicë e M.	652	827	-175
Babiq	52	96	-44.00	Jabllanicë e V.	618	715	-97.00
Baran	725	927	-202.00	Katundi i Ri	531	628	-97.00
Bellopojë	1,328	1,272	56.00	Kërstoc	142	213	-71.00
Bllagajë	735	773	-38.00	Kliqinë	705	833	-128.00
Bogë	161	24	137.00	Koshutan	219	6	213.00
Breg i Zi	245	234	11.00	Kosuriq	562	823	-261.00
Brestovik	1,814	1,718	96.00	Kotradiq	541	634	-93.00
Brezhanik	684	715	-31.00	Kryshec	779	1,009	-230.00
Broliq	427	559	-132.00	Kuçishtë	67	9	58.00
Buçan	443	677	-234.00	Leshan	622	354	268.00
Çallapek	688	947	-259.00	Lëvoshë	8	12	-4.00
Dobërdol	295	410	-115.00	Lipë	-	-	0.00
Drelaj	210	74	136.00	Loxhë	657	708	-51.00
Duboçak	20	-	20.00	Lubeniq	650	823	-173.00
Dubovë	494	650	-156.00	Lutogllavë	806	951	-145.00
Dugaivë	127	-	127.00	Llabjan	520	633	-113.00
Gllaviçicë	148	193	-45.00	Llaz-Bellopaq	4	-	4.00
Glllogjan	296	422	-126.00	Llozhan	557	597	-40.00
Gorazhdec	1,011	570	441.00	Llugaxhi	187	702	-515.00
Graboc	337	403	-66.00	Malaj	57	-	57.00
Haxhaj	129	-	129.00	Millovanc	124	279	-155.00
Jabllanicë	401	573	-172.00	Nabërgjan	1,310	1,833	-523.00
Nakëll	580	574	6.00	Ruhot	410	512	-102.00
Nepolë	308	398	-90.00	Sigë	378	346	32.00
Novosellë	1,473	1,817	-344.00	Stankaj	230	8	222.00
Osojë	254	339	-85.00	Sverkë	289	406	-117.00
Ozdrim	481	551	-70.00	Shkrel	286	-	286.00
Pavlan	492	697	-205.00	Shtupeq i M.	107	63	44.00
Pejë	41,171	48,962	-7,791.00	Shtupeq i V.	13	-	13.00
Pepiq	177	10	167.00	Treboviq	1,663	1,950	-287.00
Pishtan	45	84	-39.00	Trestenik	591	700	-109.00
Poçestë	344	404	-60.00	Turjakë	190	294	-104.00
Qyshk	1,075	1,481	-406.00	Vitomiricë	5,122	5,409	-287.00
Radavc	1,013	1,352	-339.00	Vragoc	100	141	-41.00
Ramun	446	492	-46.00	Vranoc	572	959	-387.00
Rashiq	478	759	-281.00	Zagërmë	12	27	-15.00
Raushiq	1,782	2,260	-478.00	Zahaq	1,013	1,120	-107.00
Rekë e Allagës	108	9	99.00	Zllapek	440	483	-43.00
Rosulë	14	17	-3.00				

Fshati Buçan

Nga Komuna e Pejës kemi përzgjedhur fshatin Buçan për të analizuar më detajisht trendet demografike, shkollimin, transportin publik dhe punësimin. Gjatë këtij studimi, kemi intervistuar mbi 25 familje në Buçan, duke siguruar mbulueshmëri të tërë dhe të dhëna në të cilat mund të mbështetemi.



Fshati Buçani ndodhet në një terren malor, në një lartësi prej rreth 450 metra mbi nivelin e detit. Sipas regjistrimit të vitit 2024, fshati ka një popullsi prej 443 banorësh, të gjithë shqiptarë, dhe gjithsej 87 shtëpi. Fshati gjendet rreth 15 kilometra në juglindje të qytetit të Pejës dhe kufizohet me fshatrat Baran, Vranoc dhe Nepole, duke krijuar një rrjet të ngushtë komunitar që lehtëson bashkëpunimin dhe zhvillimin e përbashkët.

Fshati ka një histori të pasur dhe një komunitet të lidhur ngushtë, ku banorët angazhohen kryesisht në bujqësi dhe blegtori për të ruajtur dhe përparuar jetesën e tyre. Buçani njihet për ruajtjen e kulturës dhe traditave, duke qenë një shembull i bukur i jetës rurale.



Bujqësia dhe blegtoria janë dy sektorët kryesorë të zhvillimit ekonomik dhe burimi kryesor i të ardhurave për banorët e fshatit. Ata merren me kultivimin e drithërave (misër, grurë dhe tërshërë), perimeve (speca, karrota, tranguj, patate, domate, qepë, hudhra etj.), si dhe me blegtorinë, duke përfshirë rritjen e bagëtive (lopë dhe viça për majmëri) dhe blegtorinë e imët (dele dhe dhi).

Buçan	1948	1953	1961	1971	1981	1991	2011	2024
Banorë	315	318	345	418	595	694	677	443
Numri i familjeve	42	38	37	40	38	53	88	87
Madhësia e familjes (mesatarja)	7.5	8.4	9.3	10.5	15.7	13.1	7.7	5.1

Tabela më lartë (me burim nga Agjencia e Statistikave të Kosovës) tregon lëvizjet e popullatës nga 1948 deri më 2024. Kulmi i numrit të banorëve ishte në 1991 kur edhe duket se shumë familje kanë jetuar së bashku që reflekton numër më të madh të ekonomisë familjare (15.7) dhe numër të vogël të familjeve (38). Me kohë, ka pasur migrim ku janë larguar banorë dhe familje, dhe është zvogëluar madhësia

mesatare e familjes (tani 5.1) por jo edhe e shtëpive pasi që me gjasë janë larguar shumica e atyre që kanë jetuar së bashku nën një kulm.

Gratë në Buçan janë shumë aktive në bujqësi, duke u angazhuar në përpunimin e frutave dhe perimeve, prodhimin e qumështit, shpezëtari dhe kultivimin e perimeve. Shumë prej tyre kanë përfituar nga mundësitë për trajnime dhe mbështetje përmes granteve dhe subvencioneve, veçanërisht për gratë fermere. Kjo i ka ndihmuar të zhvillojnë bizneset e tyre dhe të kontribuojnë në zhvillimin e komunitetit. Ndër organizatat që kanë ofruar ndihmë janë “Syri i Vizionit”, “Care International” dhe Komuna e Pejës. Dy gra nga fshati punojnë në Forcat e Sigurisë së Kosovës (FSK).

Shpërngulja. Tregimi i fshatit Buçan është tregimi i shumë fshatrave në Kosovë. Ai është shpopulluar dukshëm dhe arsyet vazhdojnë të jenë të pranishme që do t'i kontribuojnë largimit të vazhdueshëm në të ardhmen. Rreth 20 familje janë shpërngulur drejt qyteteve dhe vlerësohet se gjatë 20 viteve të fundit jashtë vendit janë shpërngulur mbi 50 familje. Para 20 vitesh, në fshat jetonin familje të mëdha që shpesh banonin në një shtëpi, ku në një shtëpi mund të jetonin deri në 50 vetë. Sot, gjërat kanë ndryshuar shumë — familjet janë ndarë, disa banorë janë larguar jashtë vendit ose në qytete të tjera, dhe tani në çdo shtëpi jetojnë mesatarisht 6-7 anëtarë. Kështu, edhe numri i banorëve është zvogëluar ndjeshëm, duke rënë nga rreth 700 në vetëm 443. *“Në fshatin tonë janë afërsisht 100 shtëpi, por vetëm rreth 80 prej tyre janë të banuara. Disa familje që janë shpërngulur kthehen ndonjëherë për fundjavë ose gjatë pushimeve,”* thotë një banor i fshatit.

Sipas banorëve, 20% të familjeve të fshatit kanë ikur për 10 vite, duke rënë nga 700 në 443 banorë.

Arsyet e shpërnguljes kryesisht janë **ekonomike** për të kërkuar mundësi më të lehta për punësim por edhe për mirëqenie më të qëndrueshme në afat të gjatë si:

(a) arsim më cilësor për fëmijët përfshirë kurset të ndryshme;

(b) qasja e vështirë në shërbime shëndetësore në fshat;

(c) mungesa e kushteve për zhvillim ekonomik e familjar përfshirë kopshtet dhe aktivitete për fëmijë;

(d) transporti jo i rregullt dhe kostoja e lartë për nxënësit – veçanërisht për ata që ndjekin shkollën e mesme në qytet.

“Po mendoj të shpërngulem sa më parë sapo të kem mundësi financiare. Kostoja për të dërguar dy fëmijët në shkollë është shumë e lartë. Për më tepër, mundësitë për punë në fshat janë shumë të kufizuara dhe të gjitha punësimet e mira janë larg.”

Cikli vicioz i shpërnguljes. Përveç arsyeve më lartë, është krijuar edhe një lloj trendi – njerëzit po e ndjekin njëri-tjetrin. Kur dikush largohet dhe e gjen veten më mirë, edhe të tjerët nisin të mendojnë njëjtë. Është bërë si një zinxhir shpërnguljeje ku largimi i një familjeje i shtyn të tjerët të ndjekin të njëjtin hap, me shpresën *“për jetë më të lehtë dhe mundësi më të mira,”* siç deklaroi njeri nga banorët e intervistuar. Rreth 30% e të intervistuarve kanë theksuar se me dëshirë do të shpërnguleshin, ose e konsiderojnë të arsyeshme largimin nga fshati në të ardhmen e afërt. Një nga familjet shprehet se po mendon të zhvendoset në qytet ose në fshatin Raushiq, për shkak të afërsisë më të madhe me Pejë dhe qasjes më të lehtë në shërbime, edukim, punësim dhe përkujdesje për fëmijët.

Arsimi në fshat nënkupton një shkollë fillore, e cila është aneks i shkollës së Baranit dhe shërben për arsimin e fëmijëve të këtij fshati si dhe të fshatrave përreth. Para 10 vitesh, mësimin e ndiqnin mbi 40 nxënës ndërsa sot në shkollën e Buçanit (e cila ofron vetëm ciklin e ulët nga klasa 1 deri në 5) janë gjithsej 18 nxënës aktiv. Po aq nxënës nga fshati Buçan ndjekin ciklin e lartë (klasat 6-9) në shkollën e Baranit, e cila ndodhet rreth 4 kilometra larg. Megjithatë distanca është e shkurtër, udhëtimi me autobus nga Buçani për në Baran zgjat rreth 30 minuta, pasi që autobusi kalon përmes fshatit Kotradiq për të marrë edhe nxënës të tjerë para se të arrijë në Baran. Përveç kësaj, një sfidë e madhe për familjet është kostoja e lartë e transportit, që arrin deri në 40 Euro në muaj për nxënës, duke qenë se transporti organizohet nga kompani private, dhe kjo përbën një barrë të rëndë financiare për shumë prej tyre.

“Edhe pse shkolla është e detyrueshme, transporti është me pagesë dhe ne nuk kemi një mënyrë të lirë ose të përballeshme për t'i çuar fëmijët në shkollë.”

Arsimi parashkollor dhe parafillor. Asnjë familje në Buçan nuk ka dërguar fëmijët në **kopsht**, për shkak se kopshti më i afërt ndodhet në qytetin e Pejës rreth 25 kilometra larg. Rreth 40% të familjeve

të intervistuarra kanë fëmijë të moshës për kopsht. Edhe pse **arsimi parafillor** është tani obligativ, vetëm rreth 20% e tyre i kanë dërguar fëmijët në parafillor në fshatin Vranoc duke përdorur veturat e tyre private. Orari për fëmijët parashkollor fillon nga ora 9:00 deri në ora 11:00 dhe nuk përshtatet me linjen e autobusit. Mirëpo edhe prindërit zgjedhin t'i dërgojnë me vetura pasi që janë shumë të vegjël dhe për shkak të sigurisë. Duke qenë se nga ky vit edukimi parafillor është bërë i obligueshëm, shumë prindër janë ende të pasigurt nëse do të arrijnë t'i dërgojnë fëmijët, për shkak të largësisë dhe kohëzgjatjes së shkurtër të mësimit (vetëm 2 orë në ditë), çka kërkon kohë dhe angazhim shtesë për transportin.

Vetëm bileta e një drejtimi kushton 2 euro, pra 4 euro në ditë për vajtje-ardhje. Kur llogarisim këtë shpenzim çdo ditë, bashkë me ushqimin e përditshëm jashtë shtëpisë, i bie që gjysma e pagës i shkon vetëm për të shkuar në punë.

Transporti publik në fshatin Buçan nënkupton vetëm një linjë 2 herë në ditë në orar të shkollës, do të thotë nuk ka transport publik të rregullt. Transporti ofrohet vetëm për nxënësit dhe funksionon vetëm gjatë ditëve të mësimit duke qarkulluar dy herë në ditë sipas orarit shkollor për të përmbushur nevojat e fëmijëve për transport për dhe nga shkolla. Kur nuk ka mësim, shërbimi i transportit ndërpritet. Transporti i fundit realizohet zakonisht në orën 18:15. Është e qarë se orari i transportit publik nuk merr parasysh oraret e

nevojshme për ata që punojnë jashtë fshatit të cilët varet në automjete private.

Punësimi. Në Buçan janë 228 burra, nga të cilët 50 punojnë në sektorin publik apo privat, ndërsa pjesa tjetër merren me bujqësi, blegtori, punë të ndryshme brenda fshatit apo në fshatrat përreth, si dhe me punë ditore me pagesë. Ata që punojnë më larg, zakonisht udhëtojnë me veturat e tyre private.

Numri i **grave në fshat është 215, nga të cilat 8 janë të punësuar** në institucione publike dhe private. Rreth 60 gra që janë në moshë pune dhe kanë aftësi për punësim nuk janë të interesuara për të kërkuar punë. Shkaqet kryesore lidhen me mungesën e transportit të përshtatshëm dhe të përballueshëm, por edhe me mungesën e kopshteve – pasi shumë prej tyre duhet të kujdesen për fëmijët. Disa gra kanë aftësi në rrobaqepësi dhe si floktare, dhe janë të interesuara për punë në këto profesione. Ka edhe të tjera që do të punonin në markete apo dyqane, por orari me ndërrime ua vështirëson shumë këtë mundësi. Ato theksojnë se, në mungesë të transportit publik, çdo i punësuar ka nevojë për dikë që ta dërgojë apo ta marrë nga puna – dhe kjo është problematike sidomos për familjet që kanë vetëm një veturë, të cilën e përdorin për nevoja të tjera gjatë ditës.

Përveç atyre që tashmë janë të punësuar, **shumica nuk e konsiderojnë të arsyeshme të kërkojnë punë.** Arsyet kryesore lidhen me mungesën e kujdesit për fëmijët, mungesën e kopshteve, vështirësitë me transportin, si dhe pagat e ulëta që nuk e arsyetojnë lodhjen dhe angazhimin. Shumë gra theksojnë se nëse ato punojnë, fëmijët mbesin pa përkujdesje – nuk ka kush t'u përgatisë ushqim apo të kujdeset për ta gjatë ditës. Këto të gjetura në këtë fshat, si edhe në fshatrat tjera shpjegojnë pse në Kosovë është tejet i ulët niveli i grave që nuk janë fare në treg të punës, dhe madje nuk figurojnë në statistika as si të papuna.

"Kam një vajzë të rritur që ka mbaruar shkollën, por është ende e papunë. Ka pasur disa mundësi punësimi në qytet, por për shkak të transportit të vështirë dhe orarit me ndërrime, ajo nuk ka mundur t'i shfrytëzojë ato."

"Jeta në fshat po bëhet gjithnjë e më e vështirë për familjen time, sidomos kur shoh që edhe të tjerët po largohen, dhe po perfitojnë punën, shkollimin, kopshtet, mjekun e tjera. Për këtë arsye, zgjidhja me e mire me duket ose me shku në qytetet ose jashtë vendit."

Vajzat e reja dhe në moshë pune në familje **shprehin dëshirë për të punuar** dhe për të pasur një jetë më aktive jashtë shtëpisë por ato përballen me pengesa të mëdha. Kostoja e lartë

e transportit dhe pagat e ulëta në nivel vendi i bëjnë ato të hezitojnë, pavarësisht se kanë nevojë reale për të qenë të pavarura dhe për të dalë nga rutina e përditshme në shtëpi.

Mungesa e transportit del të jetë një nga arsyet kryesore pse gratë dhe burrat në fshat nuk kërkojnë punë jashtë vendbanimit. Shumë prej tyre zgjedhin të merren me punë bujqësie apo angazhime brenda fshatit, për të shmangur shpenzimet e larta të transportit. Sipas të të intervistuarve, transporti (një drejtim) nga Buçani deri në Pejë kushton 1.5 Euro për fshatarët ndërsa

për nxënës kushton 1 Euro dhe ky transport operon vetëm gjatë kohës kur ka mësim. Kur nxënësat janë në pushim, transport ka vetëm prej fshatit Baran.

Puna me ndërrime e bën edhe më të vështirë udhëtimin sidomos për një fshat të thellë si Buçani që ofron qasje të kufizuar në shërbime transporti. Ka raste kur disa banorë organizohen në grupe dhe udhëtojnë me veturat e tyre personale, duke ndarë shpenzimet për të zvogëluar koston. Duke pasur parasysh që pagat nuk janë shumë të larta në përgjithësi, shumica e konsiderojnë të palevërdishme të punësohen për shkak të koston së lartë të transportit. Autobusët nuk përshtaten me oraret e punës, dhe nuk ka asnjë linjë të rregullt që të kthehet pas orës 1800 që do t'u mundësonte të gjithëve të kërkojnë punë që u përshtatet edhe sektorit privat që i punëson. Kostoja e transportit është obligim shtetëror, qoftë në nivel komunal apo qendror.

“Shpërnguljen nuk e kisha menduar, nëse do të kishim mundësi më të lehta – si qasje në ambulancë në fshat, transport publik të rregullt dhe të lirë, mësim gjithëditor, por edhe mundësi për aktivitete sportive apo kurse për fëmijët që të kenë me çfarë të merren.”

Mungesa e transportit si çënim i të drejtave të njeriut. Pasi që arsimi është obligativ, mosofrimi i shkollimit ose transportit të subvencionuar paraqet shkelje të të drejtave të njeriut dhe vërehet me përfshirje edhe në shkollimin obligativ parashkollor dhe rënie të numrit në klasë të VI-të. Për banorët që dëshirojnë të qëndrojnë në fshat, jeta bëhet gjithnjë e më e vështirë.

Rekomandimi për transport publik të subvencionuar. Do të ishte ideale që fshatrave t'u mundësohet një përmirësim i kushteve, si kopshtet, kurset, aktivitete të ndryshme jashtë-shkollore. Por gjithashtu, duhet të jemi real se sa nga këto mund të bëhen duke ditur resurset e kufizuara si financiare ashtu edhe njerëzore në vend. Paralelisht me përpjekjet për shërbime të tilla, mbase mënyra më e lehtë për të afruar banorët e fshatrave si Buçani është ofrimi i transportit të shpeshtë dhe me kosto të arsyeshme. Më shumë se gjysma e të intervistuarve besojnë se nëse do të kishte transport funksional dhe me çmime të arsyeshme, kjo do të ndihmonte në parandalimin e shpërnguljes.




Komuna e Pejës

Komuna e Pejës përfshinë **qytetin e Pejës dhe 78 vendbanime tjera dhe 19,639 shtëpi**. Mesatarisht, në **çdo fshat janë 113 shtëpi dhe 533 banorë**.

Në të gjitha fshatrat ekziston:


- infrastrukturë rrugore (përfshirë rrugë të asfaltuara),
- ndriçim publik, dhe
- trotuare.




Fshati Buçan

Fshati Buçan ndodhet në një terren malor, me një popullsi prej **443 banorësh**, të gjithë shqiptarë, dhe gjithsej **87 shtëpi**.

Popullsia në fshatin Buçan (1948 - 2024)



Familjet në Buçan



Sipas banorëve, 20% të familjeve të fshatit kanë ikur për 10 vite, duke rënë nga 700 në 443 banorë.

Numri i grave në Buçan është 215, nga të cilat 8 janë të punësuar në institucione publike dhe private.

Përveç atyre që tashmë janë të punësuar, shumica nuk e konsiderojnë të arsyeshme të kërkojnë punë. Arsyt kryesore lidhen me **mungesën e kujdesit për fëmijët, mungesën e kopshteve, vështirësitë me transportin, si dhe pagat e ulëta** që nuk e arsyetojnë angazhimin.

"Po mendoj të shpërngulem sa më parë sapo të kem mundësi financiare. Kostoja për të dërguar dy fëmijët në shkollë është shumë e lartë. Për më tepër, mundësitë për punë në fshat janë shumë të kufizuara dhe të gjitha punësimet e mira janë larg."

"Edhe pse shkolla është e detyrueshme, transporti është me pagesë dhe ne nuk kemi një mënyrë të lirë ose të përballeshme për t'i çuar fëmijët në shkollë."

"Shpërnguljen nuk e kisha menduar, nëse do të kishim mundësi më të lehta – si qasje në ambulancë në fshat, transport publik të rregullt dhe të lirë, mësim gjithëditor, por edhe mundësi për aktivitete sportive apo kurse për fëmijët që të kenë me çfarë të merren."

